

STATUTI I SHOQËRISË

**EOS.SHA**

## KREU I

### EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SË INTERNETIT ( SISTEM ME NJË NIVEL )

#### NENI 1

##### DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

- 1- Sot me datë 18.6.2021, ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri aksinare me emrin **EOS.sha**.
- 2- Themeluesit e shoqërisë janë :
  - **Salvator Delia**, i datëlindjes 11.12.1961, i biri i Palokë dhe Çile, lindur në Beltojë, Shkodër, dhe bauese në adresën : Mali Hebjaj, Bërdicë e Madhe, Nd.73 H.1, Shkodër, identifikuar me dokument me numër 033613364, dhe Nr.Personal G11211059Q.

#### NENI 2

##### OBJEKTI

##### OBJEKTI I AKTIVITETIT TË SHOQËRISË DO TË JETË :

Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegese, duke përfshirë gjithashtu si më poshtë vijon: tregtimi me shumicë i naftës bruto e nënprodukteve të saj të kategorive 0, II, III, IV e V, pa përjashtuar të nënprodukteve që destinohen për furnizimin e mjeteve të fluturimit ajror; tregtimi me shumicë i gazit të lëngshëm të naftës, kategoria I, përfshirë edhe mbushjen e bombulave me këtë nënprodukt; tregtimi me shumicë i karburanteve, kategoritë II/B e III/C, për mjetet e fluturimit. Import eksport tregtimi me shumicë e pakicë të karburanteve, lubrifikantëve, vajrave, graso, gaz e lëndë djegëse të të gjitha llojeve dhe kategorive; Prodhim, eksport-import, tregtim të materialeve të ndërtimit, si dhe të materialeve që përdoren për industrinë e naftës, gazit, ujit dhe minierave; Ushtrimin e tregtisë me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industriale, pajisje e materiale të ndryshme hidraulike dhe elektrike dhe në përgjithësi çdo aktivitet plotësues; Import dhe eksport mallra e pajisje të të gjitha llojeve, makineri e pajisje si dhe aktivitetin e shpërndarjes dhe përdorimit të tyre, për vetë shoqërinë dhe për të tjerë; Të kryejë furnizime të impianteve dhe pajisjeve teknike për aktivitetet që operojnë dhe që kane lidhje me asetet e shoqërisë; Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndërtuese, ndërtime të objekteve të ndryshme industriale e civile, prodhim të inerteve dhe materiale ndërtimi, financime që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë si dhe cdo veprimtari tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjin; Shoqëria do të kryejë veprimtari në fushën e hotelërisë, turizmit, ushqimit, administrimit, të internet-kafesë, përfshirë administrimin e aktiviteteve të lidhura me të si bar-kafe dhe shërbime si fotokopje, shitje të vogla kancelarie dhe materiale të konsumit të aktiviteteve të tjera të këtij lloji. Të hyjë në veprimtari tregtare që janë në realizimin e qëllimit të saj tregtar; Shoqëria mund të kryejë drejtpërdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesëmarrje në shoqëri të tjera të zhvillojë cdo lloj aktiviteti që lidhet dhe në mënyrë indirekte me qëllimet e shoqërisë e që vlerësohen të dobishme për arritjen e tyre; Të importojë, eksportojë dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte të ndryshme të të gjitha llojeve. Të ofrojë dhe të kryejë shërbime e konsulenca në fushën teknike dhe tregtare. Të organizojë kurse formimi dhe specializimi. Furnizimi me karburant për mjetet lundruese. Tregtimi me shumicë dhe pakicë i naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

#### NENI 3

##### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet pa afat.

#### NENI 4

##### SELIA, ADRESA E FAQES SË INTERNETIT DHE ADRESA ELEKTRONIKE.



- 4.1- Selia e shoqërisë caktohet në adresën : DURRES Porto Romano, Fshati Rinia, rruga Shën Pjetër, Terminali GEGA OIL, pasuria me numër 65/116, zonë kadastrale 3184.
- 4.2- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është : eos@gmail.com
- 4.3- Telefon : +355 693107143.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 3'600'000 ( tremilion e gjashtëqindmijë ) Lekë, i ndarë 3'600 ( tremijë e gjashtëqind ) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1'000 ( njëmijë ) lekë të një aksioni,

Aksionet e themeluesëve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm :

1-Aksionari themelues Z.Salvator Delia : lloji i kontributit 3'600'000 ( tremilion e gjashtëqindmijë ) lekë, numri i aksioneve 3'600 ( tremijë e gjashtëqind ) aksione, vlera e aksioneve 1'000 ( njëmijë ) lekë një aksion;

Numri i përgjithshëm i aksioneve është në 3'600 ( tremijë e gjashtëqind ) aksione, kapitali i regjistruar është 3'600'000 ( tremilion e gjashtëqindmijë ) Lekë, vlera e paguar është 3'600'000 ( tremilion e gjashtëqindmijë ) Lekë.

## NENI 6

### KËRKESA PËR TU PAGUAR AKSIONET

(1) Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

## NENI 7

### LLOJET DHE KATEGORITË E AKSIONEVE

Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut.

Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

## NENI 8

### EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Ekspert Kontabel i autorizuar i shoqërisë caktohet Znj.Albana Refik Canaj, me licensë me Nr.372, lëshuar me datë 15.02.2019, për një afat 2 vjeçar.

## NENI 9

### REGJISTRI I AKSIONEVE



Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.

Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin *on-line* të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

Administratorit të ngarkuar me detyrën e mbajtjes së regjistrit të aksioneve.

#### NENI 10

##### MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË AKSIONEVE

Aksionet e shoqërisë aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të Ligjit 9901.

#### NENI 11

##### ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKB.

2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.

Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

3. Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

#### NENI 12

##### ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901.

Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.

Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

#### KREU III

##### ORGANET E SHOQËRISË

#### NENI 13

##### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e përgjithshme;

2. Këshilli Administrimit
3. Administratori/administratorët.

## NENI 14 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit Administrimit
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## NENI 15 THIRRJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët dhe nga anëtarët e Këshillit të Mbikqyres apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit 9901.

Rastet e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i parashikon Neni 136 i Ligjit.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

## NENI 16 MBLEDHJET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

(1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.



Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre. Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.

Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.

Administratori ose anëtar i Këshillit të Mbikqyrës pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

#### **NENI 17 KUORUMI**

Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të Ligjit 9901, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 18 MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të aksionarëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti.

#### **NENI 19 KËSHILLI ADMINISTRIMIT**

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

Anëtarët e këshillit mbikqyrës zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të Ligjit, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e këshillit mbikqyrës mund të rizgjidhen.

Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për



t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

g) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët;

h) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

2. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë asamblesën e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Personat e mëposhtëm kanë qenë emëruar dhe emërohen si anëtarë të Këshillit Administrimit

1- Znj.Eralda Delia, e datëlindjes 22.11.1992, e bija e Elez dhe Mirjeta, lindur në Pukë, Shkodër, dhe bauese në adresën : Mali Hebjaj, Bërdicë e Madhe, Nd.73 H.1, Shkodër, identifikuar me dokument me numër BJ7054644, dhe Nr.Personal J26122038O;

2- Z.Enea Haxhihyseni, i datëlindjes 10.01.1995, i biri i Shpend dhe Etleva, lindur në Elbasan, dhe banues në K.Elbasanit, rr.Shyqyri Demiri, Nd.Pll 15/1, Ap.9, Elbasan, identifikuar me dokument me nr.BD9390980 dhe Nr.Personal J50110089L;

3- Znj.Ina Liçaj, e datëlindjes 30.04.1980, e bija e Fatmir dhe Fatmira, lindur në Tiranë dhe banuese në Rr. Islam ALLA, Nd.5, H.5, Ap.41, Njësia Administrative Nr.10, Tiranë, identifikuar me dokument me Nr.BJ0238924 dhe Nr.Personal I05430205V.

## NENI 20

### KOMPETENCAT E KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT DHE KOMITETEVE TË TIJË

1-Këshilli i Administrimit udhëzon administratorët në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kontrollon përpuethshmërinë e tyre me ligjin dhe statutin. Detyrat e mbikqyrjes së Këshillit të Administrimit, sipas shkronjave b, c, ç, d, dh, e, ë, f, g dhe I, të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 154 të ligjit nuk mund të delegohen administratorëve.

2-Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të delegojnë kompetencat e tyre cdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të këtij këshilli. Delegimi i këtyre kompetencave mund të kryhet në përputhje me kushtet e vendosura nga anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe këto kompetenca mund të revokohen ose ndryshohen. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të delegojnë detyrat e tyre që u janë ngarkuar me ligj.

3-Për sa më lartë Këshilli i Administrimit do të krijojë :

a-një komitet i cili përcakton standartet për emërimin e Administratorëve;

b-një komitet i cili përcakton skemën e shpërblimit dhe shpërblimin individual të administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

c-një komitet për kontrollin e mbarvajtjes dhe kontabilitetin e shoqërisë.

Komitetet përbëhen nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit të Administrimit, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të mos merren me administrimin e shoqërisë.

ç-Komitetet e emërimit, shpërblimit dhe kontrollit japin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve që duhen marrë nga këshilli i Administrimit, qëllimi kryesor i komiteteve është rritja e efikasitetit të Këshillit të Administrimit, duke u kujdesur që vendimet të merren në mënyrën e duhur si dhe të ndihmojë organizimin e punës me synim sigurimin e vendimarrjes që nuk përbën konflikt të interesave materiale. Krijimi i Komiteteve nuk zëvendëson çështjet e marra në shqyrtim nga Këshilli i Administrimit, i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet e marra në fushën e tij të kompetencës.

e-Në vecanti komiteti i kontrolloit financiar :

1-mbikqyr procesin e raportimit financiar;

2-mbikqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe të konsoliduara;

3-mbikqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të administrimit të rreziqeve.

4-shqyrton dhe mbikqyr pavarësinë e ekspertëve kontabël të autorizuar ose të shoqërisë së ekspertëve dhe në vecanti, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e kontrolluar.

ë-Ndryshimet e statutit dhe udhëzime të Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Këshillit të Administrimit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse nuk do të ishte kryer udhëzimi ose nuk do të ishte dhënë.

## NENI 21

### MBLEDHJET E KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

(1) Mbledhjet e Këshillit Administrimit do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshësinë e këtyre mbledhjeve.

(2) Vendimet e Këshillit Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 167 dhe nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtar në momentin e emërimit.

(3) Anëtarët e Këshillit Administrimit emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit Administrimit në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit Administrimit mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Këshillit Administrimit, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit Administrimit, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit Administrimit, pavarësisht nëse bëhet e ditur në vijim se emërimi i anëtarit të Këshillit Administrimit ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit Administrimit dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Administrimit të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Administrimit ose të një komiteti të Këshillit Administrimit është njëjloj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Administrimit ose të komitetit të Këshillit Administrimit, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

## NENI 22

### PROCESVERBALET E KËSHILLIT ADMINISTRIMIT

Këshillit Administrimit është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:

1. të gjithë takimeve të Këshillit Administrimit; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Këshillit Administrimit dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje.

## NENI 23

### SHKARKIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT ADMINISTRIMIT

Detyra e anëtarit të Këshillit Administrimit përfundon në rast se:

1. personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Administrimit në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e nenit 157 dhe pikën 7 të nenit 158..
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose



5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Këshillit Administrimit, vendos ta shkarkojë nga detyra.

#### **NENI 24 ADMINISTRATORËT**

- 1- Këshili I Administrimit zgjedh një ose më shumë persona si administratorë dhe përfaqësues të shoqërisë për një periudhë tre vjecare, në pajtim me nenin 158 të Ligjit. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas Vendimit të Këshillit të Administrimit, I cili nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Administratorët mund të shkarkohen në cdo kohë nga detyra pa cënuar të drejtat që burojnë nga kjo kontratë pune lidhur me shoqërinë.
- 2- Anëtarët e Këshillit të Administrimit përbëhen nga persona të pavaruar që ushtrojnë kompetenca administrimi.
- 3- Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorët e parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Këshillit të Administrimit të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me shkronjën "c" të nenit 135 të Ligjit.
- 4- Politikat tregtare të shoqërisë do të Administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga parashikimet e pikës 3 dhe 5 të nenit 158 dhe nenit 159 të ligjit. Detyrat e Këshillit të Administrimit, në përputhje me parashikimet e shkronjave "b, c, ç, d, dh, e, ë, f, g dhe "I" të pikës 1 të nenit 154 nuk mund t'u delegohen Administratorëve.
- 5- Ndryshimet e Statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e këshillit të Administrimit nuk do të shfuqizojnë akte të meparëshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

#### **NENI 25 SHKARKIMI I ADMINISTRATORËVE**

Detyra E Administratorit Përfundon Në Rast Se :

1. Personi nuk është më administrator në bazë të dispozitave të ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme, në pajtim me Pikën 2 të nenit 167 dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit.
2. Personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga crregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi dhe pa lejen e këshillit të Administrimit në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikqyrës, vendos, ta shkarkojë nga detyra.

#### **KREU IV DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR**

##### **NENI 26 DIVIDENTËT**

- 1- Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
- 2- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjestohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi, në rast se aksioni emërohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 3- Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.



4- Cdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria cilanuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

#### **NENI 27**

#### **KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar në nenin 146 të ligjit, mund të vendosë të kalojë kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për tu paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara me rezerva ligjore ose kapitali.

#### **KREU V**

#### **PRISHJA DHE NJOFTIMET**

#### **NENI 28**

#### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me Vendimin e Posacëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjitha ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë cdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

#### **NENI 29**

#### **BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të fillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e Legjislacionit Shqipëtarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohet Dispozitat e ligjit Për Shoqëritë Tregtare, Kodi Civil si dhe cdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 30**

#### **MOSMARRVESHJET**

Për cdo mosmarrveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij stauti, si dhe për cdo mosmarrveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe tëq tretëve, do të jetë Kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **AKSONARËT TEHEMELUES TË SHOQËRISË**

EOS.sha

Salvator DELIA

Salvator Delia

Delia